



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

## OPINION LIGJOR

### RAPORTI VJETOR I KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në kuadër të konsultimit publik të Raportit Vjetor 2021 të hartuar nga institucioni i Komisionerit për Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim Komisioneri), vlerësojmë që të ndajmë disa komente/sugjerime të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH-së), të cilat mund të shërbejnë sadopak në përmirësimin e reflektimit të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të këtij Raporti:

**a)** Në raportin e Komisionerit për vitin 2021 (fq 10) thuhet se: “Nga ky monitorim, rezultoi se 300 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, 286 kanë të publikuar kontaktet e koordinatorit dhe 217 kanë të publikuar Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, në përputhje me përcaktimet e ligjore.”, por nga ana tjetër nuk evidentohen sanksionet e vendosura nga ana e Komisionerit sa i takon kundërvajtjeve administrative të mos-publikimit të regjistrit të Kërkesave dhe përgjigjeve, të parashikuara në nenin 18 shkronja d të Ligjit. E njëjta vlen edhe për mospublikimin e të dhënave të kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 11, të Ligjit, shkelje për të cilën Komisionerit i lind e drejta sipas nenit 18 shkronja “e” të Ligjit, që të ndëshkojë autoritetin publik me gjobë.

**KShH vëren se roli i Komisionerit nuk mund të vazhdojë të jetë vetëm ndërgjegjësues, por duhet të jetë monitorues dhe sanksionues përsa i përket personave përgjegjës për hartimin, miratimin dhe përditësimin e programeve të transparencës, regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve etj.**

**b)** Në fq 11 të Raportit thuhet se: “Zyra e Komisionerit do të ndjekë këtë qasje aktive edhe për ato autoritete publike që nuk i kanë përmbushur ende detyrimet ligjore.”, **KShH vlerëson se kjo praktikë nuk është frytdhënëse, veçanërisht në rastet kur kemi të bëjmë me atë kategori informacioni publik, i cili duhej të ishte publikuar nga autoriteti shtetëror pa kërkesë.**

**c)** Referuar të dhënave të evidentuara lidhur me trajtimin e ankesave dhe hetimin administrativ, paraqitet të jenë administruar një numër shumë i lartë ankesash që reflekton mungesën e transparencës prej institucioneve. Konkretisht, Komisioneri ka disponuar 992 ankesa të reja, si dhe ka vijuar shqyrtimin e 44 ankesave të mbartura nga viti 2020, duke e çuar kështu numrin në total të ankesave në 1036. Rezulton se Komisioneri është shprehur me Vendim për vetëm 41 (pra më pak se 5% e totalit), ndërkohë që numri më i madh i tyre vërehet të jenë zgjidhur nëpërmjet ndjekjes së një qasjeje ndërmjetësuese nga ana e Komisionerit, ku për 698 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Neni 24 pika 4 e Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” parashikon se “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.” Duke parë numrin e



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

lantë të ankesave për mosrespektim të afateve dhe dhënies së informacionit, gjithashtu, vihet re se numri i vendimeve sanksionuese është i pakonsiderueshëm (vetëm 2 të tilla). Vlen të theksohet se ligji nr.119/2014, në nenin 18 ka parashikuar se në ato raste kur Komisioneri konstaton se nga ana autoritetit përgjegjës është kryer një kundravajtje administrative në kuptim të këtij neni, dënimi për këtë kundravajtje administrative është një detyrim ligjor dhe jo diskrecionar i Komisionerit.

**KShH thekson se vendimmarrja e Komisionerit është e rëndësishme, jo vetëm përsa i përket ushtrimit të funksioneve të tij si organ publik, por edhe për faktin se kjo vendimmarrje shërben si garanci ligjore në mbrojtje të së drejtës së informimit.**

**Mbyllja e ankimit administrativ, pas dhënies së informacionit nga ana e autoritetit publik, duke mos e ndëshkuar autoritetin publik për mosdhënie të informacionit, në këndvështrimin e KShH-së, është një praktikë e diskutueshme dhe jo efektive në drejtim të parandalimit të përsëritjes së praktikave të ngjashme të mosdhënies së informacionit nga institucionet publike. Sanksionimi i subjekteve që nuk zbatojnë detyrimet e ligjit, veçanërisht kur kanë tendencë përsëritëse do të shërbente përmirësimit të standardeve të së drejtës për informim dhe transparencës së organeve publike në vendin tonë.**

**d) Sa i takon regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit, KShH vlerëson iniciativën e ndërmarrë nga ana e Komisionerit për instalimin e regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve në 24 autoritete publike me fondet e vetë Komisionerit. Megjithatë, sikurse evidentohet në fq. 16 të Raportit, sërish vërehet një numër i konsiderueshëm ankesash të marra lidhur me mos-vënien në dispozicion nga ana e autoriteteve publike të informacionit të kërkuar. Në këtë situatë, KShH sugjeron vlerësimin e impaktit të regjistrin përgjatë periudhës së implementimit, nëpërmjet paraqitjes së indikatorëve konkretë dhe paraqitjes së një situatë krahasimore me vitet paraardhëse, në mënyrë që të mund të krahasohen lehtësisht indikatorët dhe ecuria e trajtimit të ankesave nëpërmjet instalimit dhe funksionimit të tij.**

**e) Lidhur me trajtimin e kërkesave për informacion dhe ankesave nëpërmjet portalit e-albania, i cili është duke u zbatuar nga 61 autoritete publike qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, KShH vëren se mungon pasqyrimi i të dhënave konkrete lidhur me zbatimin e kësaj nisme dhe ndërlikohet së saj me fushën e veprimit të ligjit nr.119/2014 dhe rrjedhimisht edhe me fushën e kompetencave të Komisionerit. Gjithashtu, vlerësojmë se do të ishte ndihmuese për publikun që të reflektoheshin indikatorë konkretë, të cilat mund të nxjerrin në pah suksesin dhe impaktin e këtij mjeti të trajtimit të kërkesave dhe ankesave.**

Në vlerësimin tonë, duhet të mbahen në konsideratë në çdo rast edhe kushtet socio-ekonomike të pjesës më të madhe të shoqërisë në vendin tonë, me fokus të veçantë shtetasit pjesë e grupeve vulnerabël dhe atyre të marginalizuara të shoqërisë, të cilat mund të kenë një akses të reduktuar në mjetet e komunikimit elektronik dhe aksesin e përdorimit të portalit e-albania.

**f) Sa i takon trajtimin të ankesave lidhur me mosrespektimin e të drejtës për akses në informacion/dokumentacion (60%), përhapjen e paligjshme të të dhënave personale (mbi 25%) dhe ato lidhur me marketingun e drejtpërdrejtë, të evidentuar në fq 20 të Raportit të**



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Komisionerit për vitin 2021, KShH vlerëson qasjen proaktive të ndjekur nga Zyra e Komisionerit, sa i takon nismave kryesisht për hetime administrative, përkatësisht 34 janë realizuar me iniciativën e Komisionerit nga 46 të tilla në total.

**g)** Sa i takon proceseve gjyqësore dhe ekzekutimit të vendimeve, të reflektuar në fq. 30 të Raportit, në përgjithësi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë i ka gjetur të mbështetura si në ligjin procedural ashtu dhe në ligjin material vendimet e marra nga Komisioneri gjatë trajtimit të ankesave. **Mgjth, për një vlerësim më të drejtë dhe objektiv lidhur me mbikqyrjen gjyqësore të vendimeve të Komisionerit (për një pjesë të tyre), duhet të pritët vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Administrativ, e cila ka një backlog (çështje të prapambetura) të konsiderueshëm.**

**h)** Sa i takon përhapjes së paligjshme të të dhënave personale të shtetasve/zgjedhësve, e ashtëquajtur si “databaza e patronazhistëve”, bazuar në relacionin e publikuar më dt. 19 Gusht 2021, në faqen zyrtare të institucionit të Komisionerit lidhur me procedurën e hetimit administrativ kryesisht (ex officio) që është realizuar prej tij për përhapjen e paligjshme të këtyre të dhënave,<sup>1</sup> **KShH ka vërejtur se disa nga rekomandimet drejtuar subjektit “Partia Socialiste” nuk përmbajnë një afat të qartë për tu përmbushur, por referohen për t’u adresuar në vazhdimësi.** <sup>2</sup> **KShH ka vlerësuar gjithashtu, lidhur me hetimin e kryer ndaj AKSHI, se Zyra e Komisionerit duhet të kishte shtrirë më tej hetimin administrativ ndaj këtij subjekti, pasi referuar ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Neni 30) dhe Kodit të Procedurës Administrative, neni 81, KDIMDP, si organ kompetent kishte hapësirën ligjore për të kërkuar dhe për tu njohur me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji për një hetim administrativ efikas dhe ezaurues.**

**i)** Sa i takon procedurës së ndjekur lidhur me përhapjen e paligjshme për kategorinë e të dhënave personale paga të punonjësve dhe targa/të dhëna për automjetet dhe pronarët e tyre, KShH evidenton se sipas legjislacionit shqiptar, KDIMDP është autoriteti përgjegjës dhe i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë drejtim, KShH vlerëson se nevojitet një mbikqyrje parlamentare nëse buxheti, burimet njerëzore dhe kapacitetet e KDIMDP-së, mundësojnë kryerjen e kontrolleve periodike në të gjitha subjektet publike dhe private që janë “Kontrollues” apo “Kontrollues të mundshëm” të të dhënave personale të qytetarëve. Bazuar edhe në rekomandimet e Raportit të Komisionit Europian për vitin 2021, Komisionerit duhet t’i caktohet staf shtesë në mënyrë që të përmbushë detyrat e shtuara të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**j)** Lidhur me projektin e Binjakëzimit, KShH vlerëson iniciativën pozitive për përmbushjen e këtij objekti dhe punën e Komisionerit për hartimin e projektligjit “Për

<sup>1</sup> Relacion hetimi administrativ për përhapjen e paligjshme të të dhënave personale të shtetasve, i aksesueshëm në:

[https://ëëë.idp.al/ëpcontent/uploads/2021/09/Relacion\\_hetimi\\_administrative\\_per\\_perhapjen\\_e\\_paligjshme\\_te\\_dhenave\\_personale\\_te\\_shtetasve.pdf](https://ëëë.idp.al/ëpcontent/uploads/2021/09/Relacion_hetimi_administrative_per_perhapjen_e_paligjshme_te_dhenave_personale_te_shtetasve.pdf)

<sup>2</sup> Raporti Vjetor për të drejtat dhe liritë e njeriut në vitin 2021, i aksesueshëm në [https://ahc.org.al/ëp-content/uploads/2022/02/Raporti-Vjetor-per-te-Drejtat-dhe-Lirite-e-Njeriut\\_2021\\_KShH-Final.pdf](https://ahc.org.al/ëp-content/uploads/2022/02/Raporti-Vjetor-per-te-Drejtat-dhe-Lirite-e-Njeriut_2021_KShH-Final.pdf), fq 28



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

mbrojtjen e të dhënave personale” të përafuar me GDPR (**Rregulloren e Përgjithshme Evropiane për Mbrojtjen e të Dhënave**) dhe Direktivën e Policisë. Gjithashtu shumë pozitiv në këtë aspekt vlerësohet puna e Komisionerit për hartimin e akteve nënligjore dytësore, ose udhëzuesve drejt unifikimit me parashikimet e GDPR si dhe aktivitetet e realizuara me synim trajnimin e stafit mbi përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në procesin e përpunimit; vlerësimin e riskut për cenimin e privatësisë apo rolet e veçanta të përpunimit të të dhënave personale dhe ndarjen e përgjegjësiave brenda organizatës/institucionit. **Ky hap vlerësohet mjaft i nevojshëm nga ana e KShH duke qënë se shpesh herë është evidentuar mungesa e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit.**<sup>3</sup>

**k)** Është për t’u vlerësuar angazhimi i Komisionerit në dërgimin e opinioneve ligjore lidhur me projekt akte rregullatore si dhe evidentimin në një aneks të veçantë të raportit dhe projekt-akteve të tjera të cilat duhej të ishin ndarë, por nuk janë ndarë për konsultim me Komisionerin. KShH vlerëson se kjo praktikë e mos-konsultimit të akteve me institucionet të cilat kanë në sferën e veprimtarisë së tyre përpunimin e të dhënave personale, nuk i shërben pozitivisht qëllimit për mbrojtjen e të dhënave personale.

---

<sup>3</sup> Rekomandim i Raport Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, i aksesueshëm në [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)